



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.72 dt.15.05.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.15.05.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara” në zbatim të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, si dhe Dekretit të Presidentit të Republikës Nr.4440, dt.04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të pa privatizuara”

VENDOSI

1. Objekti ish magazinë e Dekor Funeralit që ndodhet në rrugën “Sabaudin Gabrani” në ish Qytetin e Nxënësve të privatizohet.
2. Ambienti ish zyrë fronti e lagjes Nr.30, që ndodhet në rrugën “Muhamet Gjollesha” pallati Nr.13 të privatizohet
3. Godina e ish laboratorit Biokimik që ndodhet pranë Qendrës Spitalore Universitare të privatizohet.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ndërtim – Strehimit e Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI